



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Kabineti i Ministrit të Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of  
Justice

---

Nr. 447 /2020  
Datë: 28 / 12 /2020

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (G.Z nr. 7, 01 mars 2019), në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (19.02.2020), e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, duke u bazuar në nenin 18, nenin 28 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, si dhe në përputhje me nenin 29 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministri i Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Fatmir Halimi, noter në territorin e Komunës së Gjilanit, autorizohet si zëvendës noter për ofrimin e shërbimit noterial në territorin e Komunës së Ranillukës, pa e ndërruar selinë e zyrës noteriale.
2. Ofrimi i shërbimit noterial do të jetë në harmoni me legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen vetëm për rastin konkret.

**A r s y e t i m**

Ministria e Drejtësisë me datë 19.11.2020 ka pranuar përmes emailit kërkesën për përjashtim nga znj. Liljana Kenic e lindur Bujic, e autorizuar notere për territorin e Komunave Ranilluk dhe Partesh e cila për shkak të konfliktit të interesit kërkon përjashtimin nga ky rast të noterizoj kontratën e shitblerjes.

